



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

Numri i lëndës: 2025:147336

Datë: 29.09.2025

Numri i dokumentit: 07810818

KPPP.nr.762/2025

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Arben Toska, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Ndërmarrja Publike Infracos” ShA me NUI 811415620 dhe seli Sheshi i Lirisë p.nr., në Fushë Kosovë, kundër debitorit “Korporata Energjetike e Kosovës” ShA me NUI 811290808 dhe seli në rrugën Nëna Terezë nr.36 në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër urdhrit përmbartimor, jashtë seancës me datë 29 shtator 2025, mori këtë:

AKTVENDIM

- I. Refuzohet në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit “Korporata Energjetike e Kosovës” ShA me NUI 811290808, i ushtruar kundër urdhrit përmbartimor P.nr.503/2025 të datës 07.07.2025 të përmbartuesit privat Emine Sherifi Lubeniqi me seli në Prishtinë.
- II. Mbetet në fuqi urdhri përmbartimor P.nr.503/2025 i datës 07.07.2025 i përmbartuesit privat Emine Sherifi Lubeniqi me seli në Prishtinë.

ARSYETIM

Kreditori më 07.07.2025 ka parashtruar propozim për përmbartim (këtu e tutje Propozimi) në zyrën e përmbartuesit privat Emine Sherifi Lubeniqi me seli në Prishtinë (këtu e tutje Përmbartuesi), me të cilin ka kërkuar që të detyrohet debitori që t’ia paguaj shumën prej 445,241.66€, me kamatë prej 8%, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbartimore. Propozimin për përmbartim e kishte bazuar në faturën me numër FS-P-11-7077 të datës 24.12.2024 të tij për Debitorin, të cilën në origjinal ia ka bashkëngjitur Propozimit. Propozimit ia ka bashkëngjitur edhe kontratën për furnizim me shina S-49 të datës 24.12.2024 dhe shkresa të tjera të bashkëngjitur kontratës.

Përmbartuesi më 07.07.2025 e ka nxjerrë urdhrin përmbartimor P.nr.503/2025 me të cilin e ka lejuar në tërësi përmbartimin sipas Propozimit (këtu e tutje Urdhri).

Debitori më 11.07.2025 ka parashtruar prapësim (këtu e tutje Prapësimi) duke kundërshtuar në tërësi Urdhrin dhe i ka kërkuar gjykatës që ta aprovoj Prapësimin dhe ta anuloj Urdhrin. Ai ka pretenduar se Propozimi i lejuar nga Përmbartuesi i atakuar është përfshirë me të meta substanciale pasi që Debitori ka pranuar vetëm kopjen e titullit përmbartues dhe se kjo gjë e bënë këtë Urdhër për përmbartim të paligjshëm dhe rrjedhimisht të anulueshëm pasi që Propozimi nuk është bërë konform nenit 36 dhe 13 të LPP-së. Ka shtuar se nuk është kontestuese se kanë arritur marrëveshje-kontratë për furnizim me shina S-49 të datës 24.12.2024, obligimet që rrjedhin nga kjo kontratë dëshmojnë se Kreditori faturën e ka lëshuar në kundërshtim me të. Ka theksuar se fatura nuk është pranuar zyrtarisht e as me e-mail, e njëjta është në kundërshtim me çmimin e kontratës, në kundërshtim me sasinë e pranuar në Depon e Korporatës Energjetike të Kosovës e që arsyet e faturimit të tërësishëm nuk i dihet qëllimi i saj. Prapësimi si dokumentin e titulluar “raport i komisionit të KEK-ut për pranimin e binarëve dhe elementeve përcjellëse nga Infracos” provë, dokumentin “informim lidhur me situatën e krijuar rreth transportimit të shinave” të datës 08.07.2025, disa e-maile dhe kontratën për furnizim me shina S-49 të datës 24.12.2024, ndërsa nuk e ka kërkuar shpërblimin e shpenzimeve procedurale lidhur me përpilimin e prapësimi.

Kreditori ka paraqitur përgjigje në prapësim, me të cilën e ka kundërshtuar në tërësi atë dhe i ka kërkuar gjykatës ta refuzoj Prapësimin si të pathemeltë dhe Urdhrin ta lë në fuqi. Ai ka deklaruar se fatura është plotësisht në harmoni të plotë me dispozitat ligjore në të cilën janë qartë të cekura Kreditori, Debitori, objekti, lloji shuma dhe afati i përmbushjes së detyrimit monetar, e njëjtat është paraqitur në origjinal, konform nenit 37 dhe 40 të LPP-së dhe si i tillë është i përshtatshëm për përmbartim dhe e njëjta është pranuar në mënyrë të rregullt nga Debitori e cila evidentohet përmes vulës së protokollit me numër 365 të datës 10.01.2025 e dhënë në arkivin e Debitorit dhe e njëjta pas pranimi nuk është kontestuar asnjëherë nga Debitori. Përgjigjes në prapësim e ka bashkëngjitur si provë dokumentin “përshkrimi i mallit, dokumentin “kërkesë për pagesën e furnizimeve financiare” dhe kontratën S-49 të datës 24.12.2024, ndërsa nuk e ka kërkuar shpërblimin e shpenzimeve procedurale lidhur me përpilimin e përgjigjes në prapësim.

Pas shqyrtimit të pretendimeve të Debitorëve të paraqitura në Prapësim, dhe deklarimeve të Kreditorit në përgjigje ndaj prapësimi, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, gjykata gjeti se prapësimi është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se Kreditori i kishte lëshuar Debitorit faturën lëndore me numër FS-P-11-7077 të datës 24.12.2024 në shumë të përgjithshme prej 445,241.66€. Ajo përmban të dhëna për Kreditorin dhe Debitorin, numrin e faturës, datën e faturimit, objektin, llojin dhe

shumën, ndërsa koha e përmbushjes është përcaktuar në Urdhër dhe atë afati prej 7 ditë për përmbushjes vullnetare të detyrimit.

Fatura rezulton e pranuar nga Debitori, meqenëse në atë gjendet vula e protokollit të tij. Në shkresat e lëndës nuk ka prova se Debitori e ka kundërshtuar faturën lëndore pas pranimit të saj në ndonjë aspekt.

Situata e lartcekur rregullohet në rend të parë me nenin me nenin 29 të LPP-së, i cili në para. 1 nënpara. 3 ka rregulluar se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është (...) 1.3 faturat”* ndërsa në para. 3 ka paraparë se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*. Nga këto dispozita rrjedhë se, përmbarimi mund të fillohet edhe në bazë të faturës si dokument i besueshëm dhe se për të qenë i përshtatshëm për përmbarim dokumenti i besueshëm, ai duhet ta ketë përmbajtjen e kërkuar ligjore. Në rastin konkret, fatura lëndore i përmban të gjitha elementet e kërkuara me nenin e cituar më lartë, rrjedhimisht është e përshtatshme për përmbarim.

Përveç kësaj, gjykata konstaton se fatura në bazë të cilës është lejuar përmbarimi i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, edhe për faktin është pranuar nga Debitori, ndërsa nuk është kundërshtuar asnjëherë në ndonjë aspekt nga ai. Prandaj gjykata e gjeti se fatura lëndore i plotëson të gjitha kushtet që në bazë të saj të caktohet përmbarimi, rrjedhimisht e refuzoi Prapësimin.

Gjykata e gjen si të pabazuar pretendimet e Debitorit se fatura nuk është pranuar zyrtarisht e as me e-mail, e njëjta është në kundërshtim me çmimin e kontratës, në kundërshtim me sasinë e pranuar në Depon e Korporatës Energjetike të Kosovës e që arsyet e faturimit të tërësishëm nuk i dihet qëllimi i saj, pasi fatura lëndore është pranuar nga ana e Debitori me vulën të protokollit me numër 365 me datë 10.01.2025 andaj në këtë drejtim gjykata thekson se në rastin e mosmarrëveshjes lidhur me kushtet e kontratës përkatësisht çmimin dhe çështje të tjera mund ta zgjidhin në procedurë tjetër, ndërsa në këtë procedurë gjykata shqyrton dokumentin e besueshëm në këtë rast faturën lëndore dhe konstaton se në bazë shkresave të lëndës nuk ka prova se Debitori e ka kundërshtuar faturën lëndore pas pranimit të saj në ndonjë aspekt. Në këtë drejtim, gjykata rikujton se Debitori e ka barrën e provës për t’i provuar pretendimet e tij në prapësim, siç e obligon neni 69 para. 4 i LPP-së, i cili shprehimisht ka paraparë se *“Baza për prapësim duhet të mbështetet me prova të duhura. Provat për prapësimin duhet të dorëzohen me shkrim, përndryshe prapësimi do të refuzohet”*, andaj nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e

të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së.

Gjykata i mori parasysh edhe pretendimet tjera si të Kreditorit ashtu edhe Debitorit, megjithatë ato nuk kishin rëndësi për të vendosur ndryshe.

Gjykata gjithashtu e bëri shqyrtimin e ligjshmërisë së Propozimit dhe Urdhrit dhe gjeti se ata janë hartuar sipas kërkesave ligjore të LPP-së, ashtu që i përmbajnë të dhënat për palët, për dokumentin e besueshëm, objektin dhe mjetet e përmbarimit, si dhe janë caktuar kufijtë e përmbarimit, siç rregullojnë nenet 36 para. 1, 38 para. 1, 40, 43 dhe 49 të LPP-së.

Përveç kësaj, gjykata e sheh të rëndësishme të sqaroj se, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës vlerësoi se nuk është e domosdoshme të caktohet seancën gjyqësore për ta kuptuar plotësisht validitetin e Prapësimit, siç ka caktuar neni 73 para. 1 i LPP-së, meqë nga shkresat e lëndës gjendja faktike dhe juridike ishte qartë. Në këtë drejtim, gjykata sqaron se ajo në parim vendos jashtë seancës për prapësimin, ndërsa seanca për shqyrtimin e validitetit të prapësimit caktohet vetëm në rastet kur gjykata e krijon bindjen se pretendimet e debitorit mund të vërtetohen vetëm përmes seancës. Këtë bindje Debitorit nuk kanë arritur ta krijoj te gjykata, pasi pretendimi i tij ka mundur të mbështetet në prova të shkruara, për paraqitjen e të cilave Debitorit ka qenë i obliguar me nenin 69 para. 4 të LPP-së, ndërsa nuk ka pasur asnjë pengesë që të veprojë kështu.

Për këto arsye, në kuptim të nenit 73 para. 3 të LPP-së lidhur me nenin 13 para.1 nën para. 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi

Gjykata Komerciale e Kosovës

Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.762/2025

Gjyqtari

---

Arben Toska

UDHËZIMI PËR MJETIN E GODTIJES: Pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese ndaj këtij aktvendimi brenda afatit prej shtatë (7) ditësh nga dita e pranimit. Ankesa në formë të shkruar dhe në ekzemplarë të mjaftueshme për gjykatën dhe secilën palë tjetër dorëzohet në këtë gjykatë, ndërsa i drejtohet Dhomës së Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale.